



# Komentet e Institutit GAP në Projektligjin për Inspektoratin e Punës

**Dhjetor 2020**

Instituti GAP ka kontribuar në përmbajtjen e Ligjit të Punës<sup>1</sup>, si dhe rregullisht ka publikuar raporte për zbatueshmërinë e Ligjit të Punës<sup>2</sup>, kapacitetet e Inspektoratit të Punës<sup>3</sup>, rregullimin e pushimit të lehonisë, etj.

Siç shpjegohet edhe me memorandumin shpjegues për Projektligjin e Inspektoratit të Punës, Instituti GAP ka qenë një ndër organizatat e shoqërisë civile e cila është konsultuar gjatë procesit të hartimit të Projektligjit për Inspektoratin e Punës.

Megjithatë, Instituti GAP ka vërejtje në përmbajtjen e Projektligjit, dhe përmes komenteve të mëposhtme shpresojmë se do të evitohen problemet të cilat Instituti GAP i ka evidentuar në praktikën e gjertanishme të punës së Inspektoratit dhe të cilat nuk adresohen me Projektligjin për Inspektoratin e Punës.

---

<sup>1</sup> Instituti GAP. Rregullimi i Marëdhënies së Punës në Kosovës. Qershor 2010. Burimi: [https://www.institutigap.org/documents/86240\\_AnalizaLigjiPunes.pdf](https://www.institutigap.org/documents/86240_AnalizaLigjiPunes.pdf)

<sup>2</sup> Instituti GAP. Ligji i punës: gjashtë muaj pas hyrjes në fuqi. Qershor 2011. Burimi: [https://www.institutigap.org/documents/33549\\_GAPLigjiPunes.pdf](https://www.institutigap.org/documents/33549_GAPLigjiPunes.pdf)

<sup>3</sup> Instituti GAP. Inspektoratet në Ksoovë: organizimi dhe funksionimi. Mars 2014. Burimi: [https://www.institutigap.org/documents/34615\\_ALB-Inspektoriatet.pdf](https://www.institutigap.org/documents/34615_ALB-Inspektoriatet.pdf)


## Kostoja buxhetore

Obligimet që dalin nga Ligji i ri për Inspektoratin e Punës nuk kanë mbulueshmëri të mjaftueshme buxhetore. Në memorandumin shpjegues të Projektligjit të Inspektoratit të Punës thuhet se “*Ky institucion do të ketë si prioritet luftimin e punësimit informal, duke monitoruar dhe inspektuar të gjitha bizneset të cilat veprojnë në Kosovë, si dhe krijimin e një kulture të re të punës në vendin tone*”.<sup>4</sup>

Por, në vlerësimin e ndikimit buxhetor<sup>5</sup> thuhet se Ligji i ri nuk do të krijoj kosto shtesë buxhetore. Është e pamundur që me buxhetin aktual të Inspektoratit të Punës dhe me numrin e inspektorëve, të bëhet inspektimi i rregullt i të gjitha bizneseve. Në Kosovë janë 35.269 biznese aktive.<sup>6</sup>

Po ashtu, me deklaratën e vlerësimit të ndikimit buxhetor, e cila është hartuar në gusht të vitit 2020, thuhet se për zbatimin e Ligjit për vitin 2021 nevojiten 831,386 euro. Por, vetëm dy muaj më vonë, me Projektbuxhetin e Kosovës për vitin 2021 buxheti për Inspektoratin e Punës është ulur në 795,126 euro.

Buxheti për paga dhe shtesa në Inspektoratin e Punës për vitin 2021 është 612,826 euro, apo rreth 16 mijë euro më vogël se sa buxheti i rishikuar për vitin 2020. Numri maksimal i stafit në Inspektoratin e Punës pritet të jetë i njëjtë me vitin 2020, 90 të punësuar.



<sup>4</sup>Memorandumi shpjegues për Projektligjin për Inspektoratin e Punës. Burimi:

[http://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Documents/Memorandumishpjegues\\_t5VjssvKCL.pdf](http://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Documents/Memorandumishpjegues_t5VjssvKCL.pdf)

<sup>5</sup> Deklarata e ndikimit buxhetor të Projektligjit për Inspektoratin e Punës. Burimi:

[http://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Documents/28Deklaratabuxhetore\\_nddtgT3nSr.pdf](http://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Documents/28Deklaratabuxhetore_nddtgT3nSr.pdf)

<sup>6</sup>ASK. Rezultatet e AnketësStrukturetëNdërmarrjeve, 2019. Burimi: <https://bit.ly/3mZGpPM>

## Kriteret profesionale për inspektor/e

**Nënenin 10** janë vendosur kriteret profesionale për themelimin e marrëdhënies së punës si inspektor/e i/e punës, ku ndër të tjera kandidatët duhet të kenë kualifikim përkatës universitar në drejtësi, inxhinieri mekanike, inxhinieri ndërtimore, inxhinieri elektrike, inxhinieri kimike, sigurinë dhe shëndetin në punë dhe fusha të tjera të ngjashme.

Edhe pse në Inspektoratin e Punës duhet të ketë profesionistëtë fushave të ndërtimit e sigurisë në punë, është jo reale të pritet që një inxhinier mekanik të arrij të bëjë edhe një interpretim ligjor nga inspektimi. Në të kaluarën janë paraqitur probleme në shkrimin dhe interpretimin e vendimeve të Inspektoratit të Punës, për shkak se kimistët kanë shkruar edhe raporte ligjore. Andaj është mirë që me ligj të specifikohen rastet që kur inspektori kryesor nuk është jurist, lënda e inspektimit të shqyrtohet nga më shumë se një inspektor, ku njëri është jurist.

Po në nenin 10, thuhet se kandidatët për inspektor duhet të kenë të kryer edhe provimin profesional shtetëror për inspektor të punës. Instituti GAP vlerëson se ky është burokratizim i panevojshëm dhe trajnimi fillestar për inspektorët mund të kryhet nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike. Andaj, duhet të hiqet pika për provimin shtetëror për inspektor të punës.

## Inicimi i Procedurës Inspektuese

**Në pikën katër të nenit 14** thuhet se para inicimit të procedurës me kërkesë të palës që pretendon se ju kanë shkelur të drejtat, pala duhet të shtjerrë të gjitha të drejtat ankimore tek punëdhënësi bazuar në Ligjin e Punës në fuqi.

Kjo dekurajon ankesat e punëtorëve në sektorin privat, ngase punëdhënësit mund të përjashtojnë punëtorët nga puna ose të krijojnë kushte që ligjërisht të ndërpresin kontratat e punës për ata punëtorë që ankohen dhe kërkojnë të drejtat e tyre. Andaj, ky paragraf duhet të hiqet dhe të mbetet mundësia ku palët ankuese të mund të dorëzojnë ankesë direkt në Inspektoratin e Punës.

Për më tepër, pika 4 e nenit 14 bie ndesh edhe me **pikën 2 të nenit 15** ku thuhet që pala ankuese mund të zgjedh të mbetet anonim.

## Procedurat e inspektimit

**Në pikën 6 të nenit 15** thuhet se “inspektori i punës nxjerr vendim dhe shqipton gjobë, pas përfundimit të procedurës së inspektimit apo të ri-inspektimit, në rast konstatimit të shkeljeve të dispozitave ligjore, në afatin brenda 30 ditëve pas hartimit të raportit zyrtar.”

Ky formulim krijon paqartësi ngase nuk shpjegohet nëse vendimi nxjerret 30 ditë pas inspektimit, apo 30 ditë pas hartimit të raportit zyrtar? Sa ditë pas inspektimit duhet të shkruhet raporti zyrtar? Nëse ky formulim mbetet kështu, mund të krijohen aso praktika ku vendimet tejzgjaten shumë kohë pas inspektimit, ngase mund të vonohen hartimet e raporteve zyrtare. Për të evituar këto paqartësi, kjo pikë duhet të ndryshohet dhe të mbetet që vendimi nxjerret më së largu 30 ditë pas inspektimit ose ri-inspektimit.

## Shkeljet e rënda disiplinore

**Nënenin 22** janë listuar shkeljet e rënda disiplinore nga inspektorët e punës, mirëpo ligji nuk parasheh edhe masat që do të ndërmerren për shkelësit e këtyre rregullave. Andaj, me ligj të vendosen edhe masat ndëshkuese për inspektorët dhe procedurat që duhet palët të ndjekin në rast se kanë ankesa për punën e inspektorëve.

## Gjobat

**Nënenin 25** parashihen dënime me gjoba nga 1.000 euro deri në 10.000 euro. Ky është një dallim i madh në gjoba dhe nuk mund të lihet në diskrecion të inspektorit. A dënohet një biznes 1.000 euro apo 10.000 euro është çështje jetike për një biznes. Për më tepër, dallimi kaq i madh në gjoba minimale dhe maksimale lë mundësinë e korrupsionit të inspektorëve, ngase për një dënim minimal prej 1.000 euro, bizneset mund të korruptojnë inspektorët për ti ikur dënimit maksimal prej 10.000 eurosh.

Andaj, ligji duhet të identifikoj saktësisht se cilat shkelje janë të dënueshme me 1.000 euro, cilat me 2.000 euro, e kështu më radhë.

## E drejta e ankesës

**Në pikën 2 të nenit 26** është vendosur afati prej tetë ditësh për parashtrimin ankesave për vendimin e Inspektoratit. Kjo duhet të ndryshohet dhe të bëhet 8 ditë pune. Instituti GAP ka pasur rastin të shqyrtoj vendime të Inspektoratit të cilat i janë dorëzuar palës në festat e fundvitit ku ditë pune efektive kanë qenë vetëm dy ditë. Kjo mund të pamundësoj parashtrimin e ankesës nga palët.

## Ankesa në shkallën e dytë

Po **nënenin 26** jepen udhëzime se si palët mund të ushtrojnë ankesë në shkallën e dytë të Inspektoratit dhe se shkalla e dytë vendos për ankesën brenda 60 ditësh. Mirëpo, në Projektligj nuk ceket se nëse vendimi i shkallës së dytë është përfundimtar, dhe çfarë ndodhë nëse shkalla e dytë i jep të drejtë palës: 1. Vendimi i shkallës së dytë është përfundimtar?, apo 2. Vendimi i shkallës së dytë e rikthen lëndën në shqyrtim tek inspektori i shkallës së parë?

Praktika e gjertanishme ka qenë kjo: Pala e paknaqur me vendimin e shkallës së parë ka mund të parashtroj ankesën në shkallën e dytë. Nëse shkalla e dytë aprovon ankesën e palës, lënda kthehet tek i njejti inspektor për rishqyrtim. Instituti GAP ka parë vendime ku shkalla e dytë ka kthyer dy herë lëndën për rishqyrtim tek shkalla e parë, dhe në shkallën e parë i njejti inspektor ka marr vendime deri në tri herë për të njejtën lëndë, duke bërë që rasti të zvarritet për më shumë se një vit.

Po ashtu, nuk është e qartë se deri në sa herë shkalla e dytë mundet me marr vendim dhe kur rasti shkon në gjykatë? Në bazë të lëndëve që ka parë Instituti GAP, ka raste kur në shqyrtimin e tretë shkalla e dytë merr vendim përfundimtar, duke e orientu palën ankuese që nëse nuk është i/e kënaqur me vendimin e shkallës së dytë, ti drejtohet gjykatës.

Në ligjin e ri duhet të specifikohet se shkalla e dytë e rishqyrton lëndën nga fillimi dhe vendimi i shkallës së dytë është përfundimtar, pas së cilit palaka të drejtë që ti drejtohet gjykatës.

## Procedurat e ankesës

Edhe me Ligjin në fuqi, por edhe me Projektligjin në shqyrtim, nuk janë të qarta procedurat e ankesës. Në praktikën e gjertanishme ka pasur paqartësi se në cilën degë pala të dorëzoj ankesën: në rajonin ku është regjistruar kompania/biznesi, apo në territorin ku ka ndodhur shkelja? Andaj, me ligj duhet të specifikohet procedura e ankesës.

Instituti GAP sygjeron që ankesa të bëhet në zyret regjionale të cilat mbulojnë territorin ku ka ndodhur shkelja. Kësisoj inspektorët do të jenë më afër vendit të punës të cilin do e inspektojnë.

## Forma e ankesës

Ligji duhet të parasheh që me akt nënligjor të vendosët një standard i ankesës. Jo të gjitha palët ankuese kanë njohuri për përpilimin e ankesës. Me Ligj duhet të obligohet Inspektorati i Punës që të krijoj një platform online në të cilën jepen shjegime konkrete për ankesë, shembuj të ankesës si dhe ankesa elektronike të jetë e pranueshme. Një shembull i mirë i ankesave online është edhe platforma e Inspektoratit Policor.

Instituti GAP shpreh gatishmërinë që këto komente ti arsyetoj edhe në takim të drejtpërdrejtë ose dëgjim publik në rast se organizohet nga komisioni shqyrtues parlamentar.

Instituti GAP mbështetet nga:

